

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E AKTIVITETIT:

**"PASTRIM KIMIK"**


**Vendodhja:** Durres, Durres, DURRES, Lagjja nr.14, Shkozet, objekt me nr.pasurie 3/76/ND, zona kadastrale 8515.

**Kërkues:** Subjekti: "Mine Lloshi" Person Fizik

**Hartoi:**

**"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k**  
(Çert. Nr. 551 Prot, dt. 24.10.2008)

Administrator  
Elidiana Shehu



Mars, 2023

## Tabela permbledhese

<b>1. TE PERGJITHSSHME.....</b>	<b>3</b>
<b>2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT .....</b>	<b>4</b>
<b>3 Informacion për shkarkimet në mjedis. ....</b>	<b>8</b>
3.1 Ndikimet negative.....	8
3.2 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve.....	9
3.3 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta. ....	10
<b>4 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE.....</b>	<b>12</b>
4.1 Masat Parandaluese .....	12
4.2 Masat Kontrolluese .....	13
4.3 Masat Nderhyrese .....	13
4.4 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitet: .....	14
<b>5. PROGRAMI MONITORIMIT.....</b>	<b>15</b>
5.1 Qëllimi i monitorimit mjedisor .....	15
5.2 Objektivat e Monitorimit: .....	15
5.3 Plani i monitorimit .....	16
5.4 Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	16

## 1. TE PERGJITHSSHME

Subjekti juridik "Mine Lloshi" Person Fizik me administrator Mine Lloshi, është regjistruar në QKB me NUIS, L61418501V, si Kompania qe ushtron aktivitetin ne fushën:

Sherbim pastrim kimik, lavanderi, tregti me shumice dhe pakice te mallrave industrial. Bar kafe, restorant, ushqim i shpejte, market etj. Dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim. Tregti me shumice dhe pakice te materialve elektrike, hidraulike, elektroshtepiake, materiale ndriçimi etj. Sherbime ne fushen e mobilerise, pasisje zyresh. Materiale kancelarike, tonera dhe sherbime te tjera te ngjashme. Tregti me shumice dhe pakice te materialeve te pastrimit, detergjenteve, materialeve mbrojtëse anti Covid-19, maska dizifekant etj. Sherbime dhe tregtim te plehut organik, pemeve dekorative, fidane.

Aktiviteti Pastrim kimik, do te zhvillohet ne adresën: Durres, Durres, DURRES, Lagjja nr.14, Shkozet, objekt me nr.pasurie 3/76/ND, zona kadastrale 8515.



Ortofoto e zones se aktivitetit

Subjekti Mine Lloshi Person Fizik ka nënshkruar kontrate me zotin Jonuz Troplini, per pronën 3/76/ND, zona kadastrale 8515 ne funksion te aktivitetit te tij, Pastrim Kimik.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka infrastrukture te ngritur, infrastrukture kjo qe eshte edhe ne sherbim te aktivitetit te te gjithe zones.

Ky aktivitet do zhvillohet në përputhje me planin e zhvillimit të zones.

## 2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT

### 2.1.Vendodhja e prones

Vendodhja e aktivitetit “Pastrim Kimik Durres, Durres, DURRES, Lagjja nr.14, Shkozet, objekt me nr. pasurie 3/76/ND, zona kadastrale 8515.



*Pozicioni I zones se aktivitetit ne lidhje me ndarjen administrative*

Zona e ushtrimit te ketij aktiviteti eshte me karakter ekonomike industrial dhe tregtare duke qene se eshte afer autostrades Tirane – Durres dhe portit me te madhe te vendit, ai I Portit te Durrsit. Zona ka infrastrukture te ngritur e cila eshte edhe ne sherbim te zones se aktivitetit.

Referuar të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e ushtrimit te aktivitetit, ajo i përket zonës kadastrale Nr. 8515, Pasuria me Nr. 3/76/ND, volumi 36, faqe 37, me Indeks të Hartës DR-F-12, me sipërfaqe 396 m2, ne pronesi te zotit Jonuz Troplini.

Subjekti Mine Lloshi Person Fizik ka nënshkruar kontrate me zotin Jonuz Troplini, per pronën 3/76/ND, zona kadastrale 8515 ne funksion te aktivitetit te tij, Pastrim Kimik.

Zona ku zhvillohet aktivitet aksesohet drejperdrejt me rruge dytesore te cilat lidhin zonen e aktivitetit me rrugen kryesore "Martin Camaj" e cila sherben per lidhjen e zones me autostraden Tirane – Durres, portin e Durrsit, si edhe me autostraden Durres - Lushnje.

Referuar aktivitetit tone i cili eshte ne shërbim te subjekteve te tjera qe kane nevojte per shërbimet e pastrimit kimik, eshte mese i përshtatshëm persa i përket kategorive te lejuara per kete njësi strukturore.





*Pozicioni I zones se aktivitetit ne lidhje me rrjetin rrugore*

#### Koordinatat e aktivitetit

PASTRIM KIMIK		
Sistemin Gauss-Kruger		
Nr	X	Y
1	4373058	4578231
2	4373077	4578229
3	4373073	4578205
4	4373053	4578208
5	4373056	4578225
6	4373057	4578225

## 2.2. Lenda e pare dhe ato ndihmese

### Lendet e para

Si lende e pare ne kete proces pune perdoret tekstilet e papastra nga operatore te ndryshëm, sheterore dhe private te cilët kane nevojë per shërbimet e pastrimit kimik dhe lavanderi per tekstilet e tyre.

### Si lende te para ndihmese ne kete aktivitet jane:

Uji- Subjekti “Mine Lloshi” Person Fizik furnizohet me uji per nevoja te aktivitetit te pastrimit kimik dhe lavanderise, nga rrjeti i ujesjellesit te zones administruar nga Bashkia Durres.

Energjia Elekike - Subjekti “Mine Lloshi” Person Fizik furnizohet me energji elektrike nga rrjeti i shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektirke te zones.

Detergjente te ndryshem te ciles subjekti "Mine Lloshi" Person Fizik I siguron nga operatore te licensuar per tregetin e tyre. Aktualisht nder detergjentet qe perdoren ne kete aktivitet jane listuar ne tabelen me poshe.

Theksoj se me permiresimin apo vendosjen ne treg te detergjenteve me cilesi me te mire, natyrisht qe subjekti "Mine Lloshi" Person Fizik do ti pershtatet tregut duke perdorur detergjentet e permiresuar. Detergjentet ruhen ne ambient te vecuar nga dhoma ku jane instaluar makinerite larese te pastrimit kimik.

<b>Detergjentet qe perdoren aktualisht ne aktivitet</b>	
Ozerna Evolve	Ozerna Polar
Detaflix -Color	Ozerna Premium
Dustroff Tropical	Ozerna Special
Lizerna Aura	Sept E
Lizerna synergy	Lizerna ALKA
Lizerna Conditioner	OZERNA CARE
Lizerna Ox	OZERNA LIQUID
Lizerna Soft	

### **2.3. Procesi i punes**

Procesi I larjes bëhet me anë të makinerive te instaluar ne aktiviteti. Nepermjet nje sistemi të pompave të instaluara, të cilat sipasë programit inxhinjrik kryejne furnizimin e makinerive larese me detergjente përkatës. Sipa procesit lare dhe llojit te tekstileve qe futen ne procesin lare, duke marre ne konsiderate edhe shkallen e papastertise se tyre, kryhet edhe procesi I dozimit te detergjenteve ne makinerine larese.

Çdo gjë është automatike ku nuk preket asnjë solucion me dore gjate procesit të punës.

Te gjitha pajisjet jane automatike dhe funksionojne me energji elektrike.

Procesi I larjes përbëhet nga këto etapa:

- Larja e parë kryhet shkripëzimi dhe heqja e yndyrnave
- Larja e dytë kryhet shkripëzimi dhe meret detergjenti larës
- Larja e trete meret desifektuesi dhe aromatizuesi

Në përfundim kryhen dy procese shplarje me të cilat meret dhe aroma. Pasi kryhet I gjithë procesi I larjese së rrobave, ato kalojnë në procesin e tharjes, ku me pas janë gati në procesin e hekurosjes.

Me mbarimin e procesit të tharjes perfundone cikli I tharjes se produktete qe klientat munde te kene sjelle apo dhe shoqerit te cilat kane kontrata me ne (tekstilet munde te jene cercafe, batanije, peshqire, mbulesa etj).

Ne momentin qe vjen porosia tek ne nga klienta apo spitale ajo cohet ne dhomen e dergesave nga personat pergjegjes ku mbahet shenim cdo porosi e derguarë pasi ajo cohet tek dhoam perkatese me pas kalone ne hapat e tjer ku eshte gati te fillojne proceset e larjes.

Pasi kryhen të gjitha procedurat përkatëse produkti I larë pakëtohet në qeset perkatese dhe mbahen ne lavanderi deri sa klienti vjne dhe I mere apo behen dhe dergesat ne baza te porosive.

Cdo procesit në punë mbahet në vëzhgim nga personi përgjegjës i Shoqërisë, ku mbartë dhe menaxhimin me të madhë të punës në këte aktivitet.

Të gjitha pajisjet e punës janë të një teknologjije mjaftë moderne punë si ne kursimin e energjis elektrike ashtu dhe ne proceset e punes. Gjate procesit të punës këto pajisje kane nje vibracion mjaftë te lete per shkake te teknologjise mjaftë te larte te zoterojne si edhe balancimit qe kane.

Në ambiente e lavanderisë janë të kryera të gjitha instalimet hidraulike për furnizimin me ujë të lavanderise. Këto sisteme tubacionesh janë të lidhura me sistemin e tubacioneve te ujrave te ndotura te zones urbane.

Input: Rroba te papastra dhe te tjera per proces larje;

Output: Produkti përfundimtare:Rrobat te pastra dhe te dezifektuara;

Lëndët ndimëse :Detergjentë për larje rrobashë, (detergjente laresë, denzifektive, zbardhues, aromatizues etj) .

Energjia elektrike merret nga rrjeti kryesore I shperndarjes se OSHEE GROUP. Kjo energji sherben per venien ne pune te makinerive dhe pajisjeve te cilat sherbejne per kryerjen e proceseve teknologjike te larjese se rrobave.

Furnizimi me uje kryhet nepermjete linjes kryesore te furnizimit me uje te qytetit. Uji perdoret per kryerjen e proceseve te larjes se rrobave dhe kryerjen personale te punonjesve.

#### **2.4.Mbetjet e procesit te punes**

Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk kemi gjenerim te mbetjeve te rrezikshme. Mbetjet qe gjenerohen ne funksionimi I ketij aktiviteti jane mbetjet plastike nga ambalazhet te detergjenteve.

Pas mbarimit te sasise se detergjeneteve ne ate ambalazhim, ky I fundit shpelahet me uje te rrjedhshem I cili perdoret serisht ne procesin e larjes se tekstileve. Ne kete menyre mbetjet plastike nga ambalazhet nuk kane permbajtte te detergjenteve.

Mbetjet plastike nga ambalazhet ruhen brenda ambientit ku zhvillohet aktiviteti deri ne momentin qe do te terhiqen nga subjekte te licensuara per manaxhimin e metejsheem te tyre.

Gjithahшту nga ky aktivitet kemi edhe mbetje te perziera urbane nga aktiviteti njerezor I punonjesve. Sasia mbetjeve te perziera urbane te gjeneruar nga aktiviteti njerezor I punonjesve grumbullohen ne koshat e mbetjeve urbane te vendosur nga subjekti ne ambientet e aktivitetit, te cilet me pas depozitohen ne kontenieret e perbashket te mbetjeve urbane te vendosur ne afersi te zones se aktivitetit nga njesia e qeverisjes vendore.

### 3 Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale. Do të jenë kryesisht ujrat me detergjente të cilat shkarkohen në rrejtin e kanalizimeve të ujrave urbane të zones. Nga ky aktivitet gjenerohen mbetje ambalazhi të detergjenteve të cilat do të menaxhohen sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti njerezor i puntorëve grumbullohen në koshat e mbetjeve urbane në brendesi të zones së aktivitetit të cilat me pasë shkarkohen në kontenitoret e perbashket të mbetjeve urbane të vendosur në afersi të zones së aktivitetit nga pushteti vendor, Bashkia Durrës.

#### 3.1 Ndikimet negative

##### *Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis*

Efektet e mundshme nga ushtrimi i aktivitetit që do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për leje mjedisi tipi B. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nën-projektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

##### *Impakti në mjedis nga menaxhimi i tij*

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me aktivitetin gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

##### *Shkarkimet në ujë*

Zhvillimi i aktivitetit pastrim kimik shoqërohet me shkarkime në rrejtin e kanalizimeve. Keto shkarkime janë kryesisht ujrat me detergjente të cilat shkarkohen në rrejtin e kanalizimeve të ujrave urbane të zonës. Keto ujra janë të krahaseshme të cdo objekt banimi apo shërbimi.

##### *Emëtimet në ajër*

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk shoqërohet me shkarkime në ajër pasi makineritë larëse punojnë me energji elektrike.

Ndikimet në ajër nga funksionimi i këtij aktiviteti nuk ka.

##### *Emëtimet e zhurmave*

Sa lidhet me emëtimin e zhurmave gjatë procesit larës, duhet theksuar se ky ndikim është i minimizuar. Zhurmat e gjeneruar nga zhvillimi i këtij aktiviteti gjenerohen nga makineritë larëse. Ky ndikim është minimal pasi ambientet e këtij aktiviteti janë të vecuara dhe zhurma nuk percohen jashtë objektit ku janë instaluar makineritë.



### *Ndikimet në tokë*

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk shoqërohet me ndikime në tokë.

### *Ndikimet nga zhurmat dhe vibrimet*

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk gjeneron zhurmë të vazhdueshme dhe në nivele të larta nëse zbatohet plani I menaxhimit të zhurmave.

### *Ndikimet në florë/faunë*

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zonës në fjalë. Sheshi apo zona përreth ku do të zhvillohet aktiviteti në fjalë është i zhveshur nga bimesia pasi është zonë me zhvillime të shumta të karakterit industrial, urban, turistik etj.

Përsa me sipër vazhdimi i zhvillimit të këtij aktiviteti nuk ka ndikim në florën dhe faunën e zonës.

### *Mbetjet e prodhuara*

Mbetjet e gjeneruara janë mbetje ambalazhi të cilat do të menaxhohen sipas kërkesave ligjore në fuqi.

## **3.2 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve**

### *Toka / Përdorimi i Tokës*

Kryerja e aktivitetit brenda sipërfaqes së kërkuar për zhvillimin e aktivitetit. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.

### *Erozioni / Mbrojtja nga erozioni*

- Zbatimi rigorozi i masave teknike për operimin e instalimit.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave të shiut.
- Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të sipërfaqes së objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës.
- Mirëmbajtja e bazamentit ku do të zhvillohet aktiviteti.

### *Biodiversiteti / Vegjetacioni, Dëmtim potencial i vegjetacionit*

Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidanëve të rinj, kryesisht përgjatë rrugës që bën të mundur hyrjen për në objekt, si dhe në kufirin kufizues të pronës ku do zhvillohet aktiviteti.

### *Cilësia e ajrit / Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i instalimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit*

- Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtës.

- Mjete me kolaudim optimal.
- Pjesë këmbimi rezervë brenda objektit për raste emergjente.
- Plan veprimi në rast rrjedhjesh.
- Përdorimi eficient i mjeteve motorrike.
- Përdorim i karburanti cilësor.
- Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës.
- Pastrimi periodik ambienteve, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.

#### *Sistemi i drenazimit*

Mirëmbajtja e sistemit të drenazimit të ujrave të shiut nga pastrimi përgjatë gjithë gjatësisë së sipërfaqes së aktivitetit.

#### *Zhurmat / Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve*

- Përdorimi i mjeteve të kolauduara
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit).
- Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.

#### *Trafiku Rrugor / Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve*

- Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.
- Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

### **3.3 Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.**

- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të kete ndikime në ndryshimin e habitateve;
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të depozitohen në kontenitoret e perbashket të mbetjeve urbane në afersi të zones së aktivitetit;
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisja e punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.
- Mbetjet e riciklueshme jo të rrezikshme do të grumbullohen, transportohen dhe në oraret e caktuara nga Njësia Vendore.
- Do të merren masa për ndriçimin përreth (vendosja e impiantit të ndricimit).
- Shoqëria do të operojë në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe do të kryejë monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisore dhe trysnise në mjedis.
- Do të marrin masa në projekt për instalimin dhe respektimin e sinjalistikës së trafikut të cilat do të minimizojnë impaktet për aksidente të mundshme.
- Për të minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, do të limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me të ndjeshme, ndërmjet orës 20<sup>00</sup> e mbremjes deri në 07<sup>00</sup>

te mengjesit.

- Do te respektohen te gjitha kushtet dhe masat ne Lejen e Mjedisit qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithe perparsite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

## 4 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në aktivitet, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar, përdorimin e energjisë në mënyrë efëcente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti **“Mine Lloshi” Person Fizik**, do të hartojë “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme:

### 4.1 Masat Parandaluese

- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë operimit të aktivitetit.
- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.
- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.
- Tokëzimi në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti.
- Mbajtja gjithmone fikur e automjeteve kur nuk është e nevojshme përdorimi i tyre dhe ruajtja e distancës së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit;
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si: doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundër gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit.
- Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhesh të lubrifikantëve dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimit të tyre përfundimtar nga kompanit e nënkontraktuar.
- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundër ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike të larjes dhe të shiut, si dhe mirëmbajtja e pemëve.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.

## 4.2 Masat Kontrolluese

- Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike
- Pastrimi i ambienteve ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.
- Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.
- Vëzhgimi dhe kolaudimi i vazhdueshëm i të gjithë makinerive të transportit.
- Diferencimi i mbetjeve që gjenerohen sipas rrymave specifike;
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
- Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

## 4.3 Masat Nderhyrese

- Riparimi i menjëhershëm i difekteve dhe avarive teknologjike;
- Mobilizimi i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/makinerive nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.
- Kapja, asgjësimi i menjëhershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjëhershëm i ambientit të punës me detërgjentë të posaçëm, që mund të gjenerohen nga veprimtaria dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.
- Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve / makinerive dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.
- Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.
- Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.
- Njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme.
- Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.
- Njoftimi i menjëhershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).
- Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim.

#### **4.4 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitet:**

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i plotë i objektit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Është detyrë e zhvilluesve të aktivitetit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së operimit të aktivitetit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së marre me qira.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të ndryshme të aktivitetit.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazimit të ujrave të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjelbëruara, një mundësi e mirë dhe për vadijtje dhe



shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjëlbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.

- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Eshte ndertuar sistemi i drenazhimit dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në instalimin

## **5. PROGRAMI MONITORIMIT**

### **5.1 Qëllimi i monitorimit mjedisor**

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

### **5.2 Objektivat e Monitorimit:**

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të tij.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e funksionimit të aktivitetit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet aktiviteti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

### 5.3 Plani i monitorimit

Plani i monitorimit do të konsistojë në:

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të instalimit.
- Monitorimi i zonës së mundëshme të gjenerimit të aromave gjate zhvillimit të veprimtarisë
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura (në rastet aksidentale) në sipërfaqen e aktivitetit nën dikimin e reshjeve të shiut.
- Monitorimi i sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zëvendësime dhe fidanë të rinj. Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjetore, kohë gjatë së cilës bimët kanë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë më nevojë për shërbime.

### 5.4 Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.

Do të kryhet monitorimi i pluhurave, i zhurmës, cilësisë së ujrave megjithëse në kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

<b>Nr</b>	<b>Elementi i Monitorimit</b>	<b>Frekuenca</b>	<b>Analiza</b>	<b>Përgjegjësi</b>
1	Monitorim i gjithë shkarkimeve të ujrave që shkarkohen nga instalimi	Periodike Parametrat	Analize e plote.  kimike: nitrate, nitrite, BOD, COD, metale, hidrokarbure. Aromat, temperature, pluhurat,	Firma  Firma
2	Monitorim i shkarkimeve	Vazhdueshëm	Ne pika të ndryshme të aktivitetit	
3	Monitorim i gjendjes së mekanikës dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë.	Vazhdueshëm	Firma Zhurmat dB(A) Firma	
4	monitorimin e mbjelljes së kurorës së pemëve	Periodike	sasiore	Firma
5	Sasia e mbetjeve të magazinuara/ ruajtur	Periodike	Sasiore	Firma

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron funksionimi i ketij aktiviteti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të instalimit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zëvendësimin me fidanë të rinj. Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderushëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.